



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Drejtoria e Hetim Inspektimit

Nr. 615/2 Prot

Tiranë, më 29/03/2012

Lënda : Mbi kundërvajtjen administrative të kontrolluesit, **Hotel De Paris Tiranë, Rruga "Brigada 8", Vila Nr.7, Tiranë.**

VENDIM

Nr. 07, datë 29/03/2012

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale", pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit **Hotel De Paris, Tiranë;**

KONSTATOVA

Sipas ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", ju keni cilësinë e Kontrolluesit, pra përgjegjësinë për përpunimin e të dhënave personale dhe si i tillë keni detyrimin të zbatoni të gjitha kërkesat e këtij ligji, dhe në mënyrë të veçantë të detyrimit të parashikuar në nenin 21 të tij.

Në pikën 1 të nenit 21 të ligjit të sipërm, parashikohet: "*Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë.*"

Gjithashtu, bazuar në nenin 25 të Ligjit, kontrolluesi nuk mund të fillojë përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar më parë Zyrën e Komisionerit. Në këto kushte e konsiderojmë shkelje të rëndë përpunimin pa njoftuar e pa u regjistruar më parë në Regjistrin Qëndror të Subjekteve Kontrolluese, të administruar nga Zyra e Komisionerit. Fakti që bërja publike, bazuar në nenin 26/2 të Ligjit, është penguar për shak të mos njoftimit të përpunimit/ve që ju realizoni, mund të ketë penguar referencat e mundshme

që subjektet specifike që ju u përpunoni të dhënat mund të kishin bërë te gjendja e përpunimit/ve që ju realizoni.

Nga verifikimi i regjistrave të Drejtorisë së Regjistrimit të këtij institucioni rezulton se, deri më datë 23.03.2012, ende nuk keni plotësuar formularin e njoftimit, sipas ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

-Moszbatimi i nenit 21 të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", ju ngarkon me përgjegjësi administrative të parashikuar në nenin 39 pika 1, gërma "d", ku parashikohet dënimi me gjobë nga 10.000 deri në 50.000 lekë

Për zgjedhjen e masës së gjobës Komisioneri ka parasysh shkallën e njohjes dhe masat që keni marrë për implementimin e ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Nisur sa më sipër, në zbatim të neneve 21-23, 30/2, 39/1,4; 40 e 41, të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", 107-109 të K.Pr.Administrative, si dhe Nenit 18/a, c të Ligjit Nr.10279, datë 20.05.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative":

V E N D O S A

1. Dënimin e Kontrolluesit, Hotel De Paris Tiranë, me gjobë lekë 15.000 (pesëmbëdhjetëmijë) lekë.
2. Plotësimin e njoftimit pranë Zyrës së Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave, brenda 5 ditëve nga marrja e këtij vendimi.
3. Gjoha, arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i këtij vendimi.
4. Me kalimin e këtij afati, ky vendim shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e rrethit gjyqësor, Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

Ky vendim u dha sot me datë, 28.03.2012.

Komisioneri

Elora Çabej(Pogaçe)

